

VENDIM
Nr.118, datë 17.2.2011

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE, NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi në:

a) qarkun e Tiranës, 513 (pesëqind e trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 133 702,89 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e dy presje tetëdhjetë e nëntë) m²;

b) qarkun e Durrësit, 575 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 217 356,70 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë) m²;

c) qarkun e Shkodrës, 233 (dyqind e tridhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 59 700,42 (pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind presje dyzet e dy) m²;

ç) qarkun e Lezhës, 262 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 105 396,99 (njëqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë presje nëntëdhjetë e nëntë) m²;

d) qarkun e Beratit, 393 (treqind e nëntëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 101 247,65 (njëqind e një mijë e dyqind e dyzet e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) m²;

dh) qarkun e Fierit, 415 (katërqind e pesëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 120 325,56 (njëqind e njëzet mijë e treqind e njëzet e pesë presje pesëdhjetë e gjashtë) m²;

e) qarkun e Korçës, 59 (pesëdhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 11 818,73 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë presje shtatëdhjetë e tre) m²;

ë) qarkun e Dibrës, 10 (dhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 115,40 (dy mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë presje dyzet) m²;

f) qarkun e Elbasanit, 427 (katërqind e njëzet e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 78 567,30 (shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje tridhjetë) m²;

g) qarkun e Gjirokastrës, 12 (dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 009,90 (dy mijë e nëntë presje nëntëdhjetë) m²;

gj) qarkun e Vlorës, 532 (pesëqind e tridhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 179 876,20 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje njëzet) m²;

h) qarkun e Kukësit, 190 (njëqind e nëntëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 35 634,01 (tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër presje një) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha